



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 188, Datë 12.09.2024

MBI

**OPERIMIN DERI NË 10% MBI KAPACITETIN E IDENTIFIKUAR NË ANEKSIN A
TË LICENCËS PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, si dhe pikës 1.4 të “Kushteve të Licencës për Veprimtarinë e Prodhimit të Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.09.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1905prot., datë 11.09.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi operimin deri në 10% mbi kapacitetin e identifikuar në Aneksin A të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Në pikën 2.3 të Kushteve të Licencës për Veprimtarinë e Prodhimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.06.2016, është parashikuar e drejta e të licencuarve për të operuar deri në një limit të caktuar (deri në 10% të kapacitetit të identifikuar në Aneksin A të Licencës), pa iu nënshtruar procedurës së modifikimit të licencës.
- Po ashtu, në pikën 2.2 është parashikuar se: *I Liçensuari do të njoftojë menjëherë ERE-n për çdo ndryshim në fuqinë e instaluar të secilit prej Njësive Prodhuese ose centraleve elektrike të identifikuara ne Aneksin A që rrisin ose ulin kapacitetin prodhues të disponueshëm nga i Liçensuari.*
- Me qëllim unifikimin e rasteve dhe evidentimin e subjekteve që njoftojnë ERE-n dhe ushtrojnë të drejtën e dhënë nga licenca për të operuar deri në 10% mbi kapacitetin e identifikuar në Aneksin A, pa bërë një modifikim të elementeve të tjera të licencës së tyre, vlerësohet që në këtë Aneks të shtohet shënimi përkatës. Ky ndryshim do të reflektohet dhe në Regjistrin e të licencuarve.

- Të licencuarit do të depozitohen në ERE kërkesën, informacionin dhe/ose dokumentacionin e nevojshëm, sipas modelit bashkëlidhur, me qëllimin vijimin e reflektimit të ndryshimit përkatës në Aneksin A të licencës.
- Në referencë të përcaktimeve të pikës 1.4 të Kushteve të licencës, ERE ka kompetencën dhe të drejtën për të ndryshuar ose shtuar ndonjë element të kësaj licence dhe po ashtu të licencuarit janë të detyruar në ushtrimin e veprimtarisë së licencuar të zbatojnë dispozitat e legjislacionit në fuqi, e si e tillë ata janë të detyruar që të depozitohen në ERE qëndrimin/miratimin e institucioneve apo organeve të tjera në lidhje me operimn deri në mbi 10% të kapacitetit të instaluar.
- Brenda 10 ditëve nga depozitimi i njoftimit përkatës në ERE të licencuarit do t'i lëshohet një licencë me shënimin përkatës në Aneks, ose do t'i njoftohet mungesa e informacionit/dokumentacionit të kërkuar, vlerësim i cili bëhet rast pas rasti, në varësi dhe të detyrimeve që kanë të licencuarit ndaj organeve/institucioneve të tjera.
- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti, me nismën e vet organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencuarit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, që duan të ushtrojnë të drejtën e dhënë nga kjo licencë për të operuar deri në 10% mbi kapacitetin e identifikuar në Aneksin A të Licencës, do të njoftojnë menjëherë ERE-n, sipas formatit bashkëlidhur.
2. Në Aneksin A të licencës së dhënë këtyre të licencuarve do të bëhet shënim si vijon:
**Në zbatim të kushteve të kësaj licence, subjekti ka informuar ERE-n për rritjen deri në 10% të kapacitetit të instaluar të identifikuar në këtë Aneks dhe ka të drejtë të operojë deri në _____ (duke përcaktuar kapacitetin e shtuar të përlogaritur të secilit subjekt).*
3. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga depozitimi i kërkesës dhe/ose dokumentacionit në ERE, të licencuarit do t'i lëshohet një licencë me shënimin përkatës në Aneks, ose do t'i njoftohet informacioni/dokumentacioni që nevojitet të plotësohet.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë palët e interesuara për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

NJOFTIM

Për

operimin deri në 10% mbi kapacitetin e identifikuar në Aneksin A të licencës për prodhimin e energjisë elektrike

Unë, i licencuari, _____,
me NUIS, _____,
mbajtës i licencës nr. _____, seria _____,
miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. _____, datë _____.____._____,
për prodhimin e energjisë elektrike
nga _____
(përcakto burimin e energjisë elektrike, HEC/TEC, central fotovoltaiq/eolik),

me kapacitet të instaluar _____ MW,
(përcakto kapacitetin sikurse rezulton në Aneksin A të licencës, të shprehur në MW)

njoftoj ERE-n se kërkoj të ushtrroj të drejtën për të operuar deri në _____ %
(përcakto kapacitetin e shtuar, të shprehur në përqindje (deri në 10%) dhe në MW)

dhe evidentimin e këtij fakti në Aneksin A të Licencës.

Bashkëlidhur këtij njoftimi gjendet:

- Qëndrimi/miratimi përkatës i operatorit të rrjetit
- Qëndrimi/miratimi përkatës i ministrisë (në mungesë, shpjegimin respektiv)
(në rastet kur një gjë e tillë kërkohet nga kontrata)
- Qëndrimi/miratimi përkatës i organeve përgjegjëse për menaxhimin e burimeve ujore (në mungesë, shpjegimin respektiv)
(në rastet e HECT/TEC)
- Qëndrimi/miratimi përkatës i organeve përgjegjëse për menaxhimin e mjedisit (në mungesë, shpjegimin respektiv)
(në rastet kur ndryshon sipërfaqja e ushtrimit të veprimtarisë)
- Çdo informacion/dokument tjetër që konsiderohet i nevojshëm
_____ (specifiko)

Jam i vetëdijshëm se çdo rritje e kapacitetit të instaluar, që kalon 10% të sasisë së kapacitetit të identifikuar në Aneksin A, do të kërkojë një amendim të kësaj Licence, ndaj angazhohem të operoj sipas kapacitetit të njoftuar më sipër.

Për të licencuarin

(emër mbiemër, nënshkrim)